

Titulli/Grada Profesor i Asociuar Emër Mbiemër Artemisi Shehu Dono

E punësuar me kohë të plotë si personel akademik me kohë të plotë pranë Departamentit Pedagogji-Psikologji, të Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës.

Ka një përvojë pune 22 vjeçare si pedagoge dhe studiuese.

Pas diplomimit në Psikologji klinike, në vitin 2000, studimet pasuniversitare dhe ato doktorale lidhen me fushën klinike në Psikologji dhe specifikisht me “Efikasiteti i trajnimit të prindërve në mbështetje të trajtimit të fëmijëve të tyre me autizëm”

Ka mbrojtur titullin akademik Profesor i Asociuar në vitin 2016.

Fushat e mësimdhënies dhe ekspertizës kërkimore përfshijnë psikologjinë anormale dhe psikologjinë klinike të fëmijëve, adoleshentëve dhe të rriturve.

Anëtare bordi e Senatit akademik të Universitetit të Tiranës nga prill 2016 deri 2020.

Anëtare bordi në Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile (KKSHC), zgjedhur nga organizatat e shoqërisë civile në maj 2016. Ky këshill do të ushtrojë fuqinë e tij nga Maji i 2016 deri në 2019.

Ka botuar disa tekste akademike si “Psikologji Anormale“, “Psikologji Komunikimi“, “Psikopatologjia e zhvillimit“, “Psikologji Mjekësore“, “Psikopatologji e fëmijëve dhe adoleshentëve“, etj.

Është autore e shumë artikujve shkencorë të botuar në revista kombëtare dhe ndërkombëtare, me faktor impakti.

Ka qenë recensente shkencore e librave si “Psikologji 11” (për klasën e njëmbëdhjetë të gjimnazit, “Psikologjia kognitive”, “Intervista e strukturuar klinike për Çrregullimet e DSM-5” (Versioni i Mjekut), “Intervista e strukturuar klinike për Çrregullimet e DSM-5” (Versioni i mjekut, Udhëzuesi i përdorimit), “Mënyrat e të nxënit”, etj.

Gjithashtu, është pjesëmarrëse në dhjetra konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare për prezantime të studimeve në vend, rajon e më gjerë.

Aktualisht ajo është pedagoge, lektore e parë në Departamentin Pedagogji- Psikologji, të Fakultetit të Shkencave Sociale, ku leqtron lëndë të ndryshme të fushës klinike si në programet Bachelor në Psikologji ashtu edhe në programet Master shkencor dhe Master Profesional. Ajo është anëtare për të dytën herë pranë Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë pranë UT. Ajo është antare e Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore ‘Doktor’ pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, si dhe Koordinatorë e programit të Doktoraturës pranë Departamentit Pedagogji-Psikologji. Gjithashtu, është konsiderueshëm aktive në jetën akademike si kërkuese shkencore duke kontribuar në zhvillimin e fushës në vend e më gjerë përmes prezantimeve të punëve shkencore në konferenca kombëtare e ndërkombëtare si dhe botime në vend, rajon e më gjerë. Është antare bordi shkencor në jo pak konferenca kombëtare e ndërkombëtare në vend e rajon në 5 vitet e fundit e në vijim. Ajo

është eksperte e fushës pranë ASCAL në vlerësimin e programeve të fushës së Psikologjisë në 10 vitet e fundit. Si mbajtëse prej 2007 të Certifikatës Europiane për Psikoterapi Psikodinamike, ajo është psikoterapiste në fushën klinike.